



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

<b>Për:</b>	Naim Ismaili, Kryetar i Komunës së Shtimes Medina Brahaj, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Shtimes	
<b>Cc:</b>	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
<b>Përmes:</b>	Ivan Todosijević, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme	
<b>Nga:</b>	Shkëlqim Jakupi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave, MAPL	Datë: 15/05/2018 Nr.020-543
<b>Lënda:</b>	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Shtimes	
<b>Lloji i aktit:</b>	Vendim i Kuvendit të Komunës	


I nderuar Kryetar,  
E nderuara Kryesuese,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi Npi-01/89 për rizgjedhjen e Komitetit për Komunitete
I miratuar më datë: 30.04.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 07.05.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Za :	Naim Ismaili, gradonačelnik Opštine Štimlje Medina Brahaj, predsedavajuća Skupštine opštine Štimlje	
Kopija:	Jedinica za administraciju dokumentacije u MALS-u Jedinica za administraciju dokumentacije u opštini Zakonsko odeljenje i monitorisanje opština-MALS	
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a, <i>[Signature]</i> Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka u MALS-u, <i>[Signature]</i>	
Od:	Shkëlqim Jakupi, rukovodilac Odeljeja za zakonska pitanja i monitorisanje opština, MALS <i>[Signature]</i>	Datum, 15.05.2018 Br.020-543
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta Skupštine opštine Štimlje	
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine	

Poštovani gradonačleniče,  
Poštovana predsedavajuća,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka Npi-01/89 za ponovni izbor Odbora za zajednice
Usvojena dana, 30.04.2018.godine,
Predložena za razmatranje u MALS-u, dana, 07.05.2018. godine,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je isti u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak. Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME**  
 Nr.01-060/01-11942 datë:18.04.2018



Npi - 01/89 datë: 30.04.2018

Duke u bazuar në nenin 12, nenin 51 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040; Nenin 34 të Statutit të Komunës së Shtimes Nr.01-06/1636, dt. 03.09.2008, si dhe duke u bazuar edhe në rekomandimin e Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal për rishqyrtimin e vendimit të Kuvendit Nr.01-060/01-6636/41 të datës: 09.03.2018, Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 30.04.2018, aprovoi këtë:

KRYESIA - INCOMING			
KUVENDI I KOMUNËS SHTIME			
MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL			
MINISTARSTVO LOKALNE SAMOUPRAVE I ADMINISTRACIJE			
MINISTRY OF LOCAL GOVERNMENT ADMINISTRATION			
Data	09.05.2018		
Datum			
Date			
Emri organizatove	Nr. i Lendës	Shtojca	Vite
-07-	020-573		

**V E N D I M**

**PËR RIZGJEDHJEN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e katërt të rregullt për vitin 2018, e mbajtur më datën: 30.04.2018, me shumicën e votave, aprovoi Vendimin për rizgjedhjen e Komitetit për Komunitete në këtë përbërje:


Nr.	Emri dhe Mbiemri	Përfaqësimi
1	Fatmire Ferati	Anëtare e Komitetit nga (PDK)
2	Diarta Vishesella	Anëtare e Komitetit nga (AAK)
3	Muhamet Ademaj	Anëtar i Komitetit nga (AKR)
4	Rrahman Kadrija	Anëtar i Komitetit nga komuniteti ashkali (PAI)
5	Xhevahire Ramadani	Anëtare e Komitetit nga komuniteti ashkali (PAI)
6	Ruzhdi Brahimi	Anëtar i Komitetit nga komuniteti ashkali (PDAK)
7	Arton Demiri	Anëtar i Komitetit nga komuniteti rom (PRIPK)

II

Vendimi i mëparshëm i Kuvendit të Komunës së Shtimes, Nr.01-060/01-6636/41, të datës 09.03.2018, për zgjedhjen e Komitetit për Komunitete, anulohet.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Antarëve të Komitetit, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit  
 Medina Brahaj